



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:023640

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06590385

C.nr.79/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H.G nga fshati Bratotin, komuna e Rahovecit, D.S nga fshati Dobidol, Komuna e Rahovecit dhe K.L nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson avokati R.H nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 324.72.00 euro, jashtë seancës, me datë 12.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësve H.G, K.L dhe D.S.

- I. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses H.G, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 01.12.2022, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) =55.35 euro x 2 muaj, t'ia paguaj shumën prej 110.70 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 22.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses K.L, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 01.12.2022, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (393.00 euro) x 27% (minusuar 54.45 euro në listën e pagave nga shuma 106.11 euro) =51.66 euro x 2 muaj, t'ia paguaj shumën prej 103.32 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 22.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses D.S, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 01.12.2022, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421.00 euro)

x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) =55.35 euro x 2 muaj, t'ia paguaj shumën prej 110.70 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 22.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

- IV. HEDHET POSHTË si e palejueshme padia e paditëseve H.G, K.L si dhe D.S, në emër të inflacionit, për shkak të mosplotësimit dhe precizimit të padisë.
- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve H.G, K.L si dhe D.S, t'i paguajë shumën prej 177.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset H.G, K.L si dhe D.S, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 22.01.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 324.72 euro, ndërsa me datë 16.09.2024 me parashtrësë ka bërë përmisimin, plotësimin dhe precizimin e kërkesëpadisë.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SH.F.M.U. “Tre Dëshmorët” në fshatin Vrajakë - Bratotin, komuna e Rahovecit. Paditësve duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit të Punës 03/L-212, neni 90 dhe Kontratë Kolektive të Arsimit të Kosovës, të datës 22.01.2021, përkatësisht neni 7 i kësaj kontrate dhe Vendimit të Qeverisë së Kosovës, me nr. 03/2008 neneve 3 dhe 4 si dhe nenit 35 par 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës. Andaj i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 21.03.2024, ku ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin padia e tillë është e pathemeltë dhe e pa bazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit. Padia e paditëseve nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën të cilën janë thirrur rezulton të jetë e pa vlefshme.

Ka theksuar që paditëset, me Aktgjykim C.nr.896/2021, me numër të lëndës 2021:189911, të datës 24.08.2024, janë kompensuar në emër të licencimit, ndërsa me datë 26.03.2024 kanë bërë precizim të kërkesëpadisë në aspekt objektiv duke kërkuar kompensim edhe për inflacion vjetor, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësve ta hedhë poshtë si të palejuar për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë-litispedencës, konform nenit 391 pika c) të LPK-së.

Paditëses me padi ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve në emër të kualifikimit dhe inflacionit me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë, të cilën e konteston në ëtrësi, sepse konsideron se kamata duhet të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, respektivisht nga dita kur paditësve u njihet e drejta e kompensimit, kur edhe e paditura kupton në bazë të aktgjykimit lidhur me detyrimet financiare që i ka ndaj paditësve.

Andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësës ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/481 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësës H.G; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/272 e datës 04.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësës K.L; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/230 e datës 03.09.2018, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësës D.S; diplomën Nr. 1032 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prizren, e paditësës H.G; diplomën Nr. 852 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Edukimit, Shkolla e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, e paditësës K.L; diplomën Nr.475/15 e lëshuar nga Kolegji AAB për paditësen K.L; diplomën Nr. 531 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Fakulteti i Edukimit, e paditësës D.B; licenca e mësimdhënësit nr.1007944 e paditësës H.G; licenca e mësimdhënësit nr.1009461 e paditësës K.L; licenca e mësimdhënësit nr.1007945 e paditësës D.S; si dhe listat e pagës për paditëset.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditëset kishin të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditëset posedojnë licenca. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe licencimit, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/481 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësës H.G, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Tre Dëshmorët” në Vrajakë - Bratotin.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/272 e datës 04.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses K.L, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Tre Dëshmorët” në Vrajakë - Bratotin.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/230 e datës 03.09.2018, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses D.S, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U “Tre Dëshmorët” në Vrajakë - Bratotin.

Me administrimin e diplomës Nr. 1032 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prizren, e paditëses H.G, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.G ka përfunduar studimet më 16.11.2017 dhe mori titullin Bachelor i Programit Fillor.

Me administrimin e diplomës Nr.852 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Shkolla e Lartë Pedagogjike - Gjakovë, e paditëses K.L, gjykata vërtetoi faktin se paditësja K.Lka përfunduar studimet më 26.11.2007 dhe mori titullin Arsimtar i Historisë - Gjeografisë.

Me administrimin e diplomës Nr.475/15 e lëshuar nga Kolegji AAB, e paditëses K.L, gjykata vërtetoi faktin se paditësja K.L ka përfunduar studimet më 27.05.2015 dhe mori titullin Baçelor (BA) në përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve.

Me administrimin e diplomës Nr. 531 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, e paditëses D.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësja D.B ka përfunduar studimet më 19.12.2011 dhe mori titullin Baçelor i Programit Fillor.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 1007944, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.G është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 1009461, gjykata vërtetoi faktin se paditësja K.L është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 1007945, gjykata vërtetoi faktin se paditësja D.S është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.G ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja K.L ka pasur pagën bazë 393,00 €.

Me administrimin e listës së pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja D.S ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë së paditësve për shkak se në bazë të Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4 të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës. Në këtë rast paditësve H.G, K.L dhe D.S, në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedojnë diplomë universitare i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 27%.

Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve H.G dhe D.Si ka paguar shumën prej 58,32 euro, ndërsa paditëses K.Li ka paguar shumën prej 54.45 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. II. dhe III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parasheh *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit është *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe pretendimet e të paditurës se kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar nuk qëndrojnë, pasi që padia është parashtruar me datë 22.01.2024, brenda afatit kohorë.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e të paditurës, që për të njëjtën çështje paditëses janë kompensuar në emër të licencimit, me Aktgjykim C.nr.896/2021 në Gjykatën Themelore në Gjakovë- Dega Rahovec, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që gjykata ka gjetur që paditëset janë kompensuar, mirëpo bëhet fjalë për një periudhë tjetër e që është 01.08.2018 deri 21.11.2022, ndërsa periudha e kërkuar me padi është 01.12.2022 deri më 31.01.2023, pra kemi

të bëjmë me një periudhë tjetër nga ajo që është kërkuar me padi, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata fillimisht e ka kthyer padinë për plotësim, përfaqësuesi i autorizuar i paditëseve nuk i ka heq pengesa, andaj gjykata ka vendosur ta hedhë poshtë si të palejuar kërkesëpadinë e paditëseve H.G, K.L dhe D.S në emër të inflacionit, për shkak të mosplotësimit të padisë, duke u bazuar në nenin 391, ku përcaktohet se *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:”* dhe pika *“g) paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligj”*.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditëses janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi në tërësi pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë të paditësës shumën si në pikën V. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 177.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 156.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.79/2024, më datë 12.12.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.